



Botimi Nr. 5. Tetor 2019

Tetori Rozë

Rriti flokët për
t'i dhuruar, **historia**
frymëzuese e Donjetit

Rrëfimi i zysh Soneles:
11 VITE NË BETEJË
ME KANCERIN E GJIRIT

Sondazhi në Evropën
Qendrore dhe Lindore
Të dhënat për
pacientët
me kancer

Fakte thelbësore mbi
kancerin e gjirit
Dr.Orges Spahiu

Kanceri i gjirit, një kauzë
që meriton më shumë vëmendje



Përmbajtja

Ky është një botim informues për kancerin e gjirit nga **Europa Donna Albania** dhe shpërndahej falas në të gjithë Shqipërinë.

Tetori rozë dhe Europa Donna Albania	3
Rrëfimi i zysh` Soneles: 11 vite në betejë me kancerin e gjirit	4
Fakte thelbësore mbi kancerin nga Dr. Orges Spahiu	7
Rriti flokët për t'i dhuruar, historia frymëzuese e Donjetit	11
Të dhëna për pacientët me kancer, rezultatet e sondazhit që përfshiu Evropën Qendrore dhe Lindore	12
Kanceri i gjirit, një kauzë që meriton vëmendjen e të gjithëve ne	14



Tetori rozë dhe Europa Donna Albania

“Muaji i Ndërgjegjësimit të Kancerit të Gjirit” është një fushatë vjetore në të gjithë botën që zhvillohet në muajin tetor për të nënvizuar rëndësinë e ndërgjegjësimit, edukimit dhe kërkimit.

Gjatë Muajit të Ndërgjegjësimit të Kancerit të Gjirit, Europa Donna Albania synon të përfshijë sa më shumë njerëz në rritjen e vetëdijes për kancerit e gjirit.

Muaji i Ndërgjegjësimit të Kancerit të Gjirit bën diçka të shkëlqyeshme - bën të mundur shumë studime jetë-shpëtuese teksa mbështeten duke u veshur rozë, pasi në shtete të fuqishme realizohen fushata të mëdha donacionesh për kërkimet shkencore.

Çfarë mund të bësh ti në Shqipëri?

Ka shumë mënyra të tjera për t'u përfshirë dhe mbështetur punën tonë gjatë muajit të ndërgjegjësimit të kancerit të gjirit por edhe gjatë gjithë vitit. Nga fushatat për të ndihmuar gratë të kenë qasje në ilaçet e kancerit të gjirit, për të ndarë eksperiencë personale dhe informacion për kontrollin e gjinjve, mbështetja juaj do të ndihmojë këto vajza dhe gra.

Mbështesni punën tonë

Europa Donna Albania ka planifikuar një sërë aktivitete për “Tetorin Rozë” të cilat janë vazhdimësi e një punë që bëhet gjatë gjithë vitit

në bashkëpunim me të gjithë aktorët ku në fokus janë gjithnjë pacientët.

Disa prej aktiviteteve të EDA:

“Ju tregoj historinë time”- takim me pacientët dhe stafin mjekësor e psikologjik tek ‘Onkologjiku’. Historitë personale frymëzojnë dhe ndikojnë. Takime të tilla bëhen gjatë gjithë vitit në bashkëpunim me Europa Donna Albania dhe Onkologjikun në Tiranë.

“Pedalo për jetën”- një aktivitet që përfshin dhe disa iniciativa të tjera të ndërmarra në kuadër të Ditës së Shëndetit të Gjirit e cila ka në fokus aktivitete sportive dhe fizike për t'i dhënë rëndësi dhe vëmendje jetesës së shëndetshme.

“Dhuro flokë, fal shpresë”- Me 19 Tetor në orën 10:00 realizohet për herë të katërt fushata e dhurimit të flokëve. Një prej aktiviteteve më të rëndësishme të EDA, e cila përmes kësaj fushate komunikon mesazhe shumë të rëndësishme dhe nevojat reale të pacientëve. Një fushatë ndërgjegjëse e sensibilizuese që çdo vit merr vëmendje nga qytetarët, mediat dhe të gjithë ata që interesohen ndaj kësaj kauze.

Për çdo informacion dhe pyetje për aktivitetet e “Tetorit Rozë” të Europa Donna Albania mund të ndiqni të gjitha faqet dhe rrjetet sociale me të njëjtin emër.



Të jetosh çdo ditë me kancerin e gjirit, Sonela rrëfen betejën e saj 11-vjeçare me kancerin e gjirit

Para 11 vitesh, Sonela Totraku nisi një rrugëtim të ri, që nuk ishte në planet e saja. Teksa vraponte për të realizuar pasionet dhe dëshirat dhe mendonte se kishte kohë për t'i kapur këto ëndrra, jeta e përballi me një sfidë.

Në moshën 32-vjeçare, teksa Sonela shikonte një program televiziv, pickimi i një mushkonjë hapi një portë që mësuesja e 'Gjuhë-Letërsisë', nuk do dëshironte kurrë. E ndërsa e bezdisur nga mushkonja tenton ta godasë, dora e Sonelës ndjeu diçka që në Veri të Shqipërisë shpesh thonë "Zot bane andërr".

Teksa ndjesitë nga dora tek krahu që u ndjenë thellë në zemër, me një shpejtësi marramendëse u përthithën nga truri i cili dha mesazhin se ajo gjëndër nuk është gjë e mirë në gjirin e saj.

"E pabesueshme! Asnjëherë në jetën time, as në makthet më të këqija të saj nuk e kisha menduar se unë do të sëmurem me këtë sëmundje të rëndë. Isha vetëm 32 vjeçe."

Sonela, më pas tregon rrëfimin se çfarë ndodhi pasi dora i preku gjendrën:

U tremba. Vrapoj t'ia rrëfej mamasë. Të dyja vendosëm që të hënën do të shkonim te doktori. Nuk e besoja se do të ishte ndonjë gjë e keqe. Vajta të hënën në spital dhe pas kontrolleve të shumta rezultoi se unë duhet të operohesha. Momenti më i vështirë ishte kur doktori më tha: "Dil jashtë se dua të flas me mamënë tënde!". Unë nuk pranova. "Nxirre mamënë time jashtë dhe më thuaj ç'ke për të thënë!". As unë nuk e di se nga më buronte tërë kjo forcë. Unë nuk qaja, por vetëm u jepja forcë e kurajë të gjithë familjarëve të mi. Pas operacionit të parë isha në pritje të përgjigjes së biopsisë.



Studio e skulpturës "Thanas Papa"

Studio e pare e ndërtuar ne Shqipëri nga shteti me paracaktim për skulptorin Thanas Papa, e ndërtuar ne vitin 1958

Më pas, Sonela tregon se pritja për të marrë përgjigjen e biopsisë ngjante sikur ishin vite dhe ditët nuk po kalonin.

E tmerrshme!!! Diagnoza ishte kancer i gjirit. Një operacion tjetër më priste, më i vështirë...

Por Sonela e dinte që operacioni ishte më pak i dhimbshëm krahasuar me atë që e priste.

Trajtimet!!

“U informova për çdo transformim që do të ndodhte në trupin tim. Pas cikleve të kemios, bëra rreth dy muaj radioterapi. Dalëngadalë gjurmët e sëmundjes po largoheshin. Ndërkohë që parukja, duke qenë se ishte dimër, më shkaktonte shqetësime si pasojë e shirave apo erërave të forta. Kishte ardhur koha që ajo të hiqej. Ndoshta ju duket e çuditshme, por nuk kishte lumturi më të madhe për mua të ecja e lirë në shi, se tashmë nuk ishte parukja që mund të dëmtohej.”

Por kur dukej se për Sonelën kishte një rreze drite dhe shprese, ajo u përball me një moment akoma më të vështirë. Vetë zysha e krahason momentin, kur mori vesh lajmin se qelizat ishin riaktivizuar, me një termet.

“U theva, mendova se çdo gjë mori fund. Jeta më shkonte para syve e më vinte keq se kisha akoma shumë gjëra për të bërë, se isha e re dhe se në fund të fundit e doja jetën. Po po unë e dua jetën e luftoj çdo ditë për të jetuar. Nuk jetoj në botën e përrallave, përballem me probleme të rënda që vështirësojnë ekzistencën time. U operova edhe dy herë të tjera, tashmë numëroheshin katër operacione dhe dy herë ciklet me kimioterapi. Lufta ime vazhdon mes kemiove e ilaçeve pafund.

Por si është për Sonelën, të jetojë çdo ditë me këtë sëmundje?

Jeta është një luftë e kush më mirë se sa unë e di këtë. 11 vjet janë shumë. E në këto vite kam pasur dhe unë momentet e mia të vështira. Edhe unë kam qarë, edhe unë e forta kam përjetuar momente dobësie, unë e hekurta i jam trembur vështirësive të jetës. Tashmë kjo sëmundje është bërë pjesë e pandarë e jetës sime. Jetoj me të, luftoj me të, punoj me të... U desh kjo s që unë të njoh më mirë veten time, të zbuloj karakterin e fortë, dëshirën për të jetuar,

këndvështrimin pozitiv të gjërat sado të rënda që të jenë ato. Luftoj çdo ditë me forcën e shpirtit se unë e dua jetën. E në gjithë këtë rrugëtim plot sfida e vështirësi, shpesh herë më forcë e vullnet por ndonjëherë pa pikë shpresë. Duke provuar çdo mundësi të ndryshme, Sonela buzëqesh. Dhe për të gjithë ne që e njohim Sonelën dhe forcën që e karakterizon, dëshirojmë që të ndajmë me ju si i nis zysha e bukur dhe e qeshur ditët, pasionet dhe dëshirat e saj.

Si e nis ditën Sonela?

Çdo mëngjes zgjohem e lumtur se do e jetoj. Çdo ditë jam në punë në profesionin që unë e adhuroj, atje mes nxënësve të mi, që më ndriçojnë jetën. Ata janë dielli i jetës sime.

Mal apo det?

E adhuroj detin. Nuk ngopem me të. Ngjan pak dhe me jetën time, herë i qetë e i bukur, herë i frikshëm, plot dallgë e stuhi.

Fytyra jote ka shumë dritë dhe buzëqeshje, nga buron forca?

Në këtë luftë të ashpër, unë jam e armatosur me fjalën time, me buzëqeshjen në buzë e dashurinë në shpirt. Forca ime buron nga familja ime, nga të mrekullueshmit e mi, nga prindërit e mi dhe dy motrat e mia. Ata më kanë mbështetur e vazhdojnë të më mbështesin edhe përtej mundësive të tyre. Nëse unë sot jetoj, është meritë e tyre.

Pa çfarë nuk mundet të jetojë Sonela?

Pa familjen time të shtrenjtë. Ata janë vetë jeta ime.

Si mësuese e Gjuhë-Letërsisë që je, cili është autori yt i preferuar? Pse?

Gjithmonë më ka pëlqyer Migjeni. Ai ishte një uragan që nuk bëri kompromis me të keqen, por pati guximin qytetar për ta goditur atë pa mëshirë në kërkim të qytetërimit, të një jete më të mirë e të një shoqërie progresiste.

Nëse do ishe fotografe, çfarë shkrepje do i bësh jetës tënde? (atë realin apo imazhin perfekt që ke në mendje)

Një aktore italiane Anna Magnani thotë: “Mos më hiqni asnjë rrudhë! I kam paguar shtrenjtë të gjitha”.

Prandaj jeta ime jashtë realitetit nuk do të kishte kuptim. Pavarësisht vuajtjeve, kjo sëmundje më ka bërë më të fortë, më sociale, kam njohur plot miq e mikesha të forta që si unë luftojnë për të jetuar.

periudhë të jetës të mbizotërojnë e zeza, grija ... kjo nuk do të thotë se ngjyrat e tjera nuk janë aty. Mjafton të hapim sytë me dëshirën për ta jetuar jetën ashtu si na vjen, me ditët gri apo plot ngjyra



Realizoi fotot: Blerina Xhemajli

Nëse ti do të kishe në dorë të ndryshoje diçka nga sistemi, cila do të ishte?

Shumë gjëra kanë ndryshuar, por akoma duhen... Nuk e imagjinoj një vend evropian ku mungojnë ilaçet e duhet t'i blesh. As nuk konceptohet. Këtu ndodh... Ka njerëz që fatmirësisht kanë bashkëjetuar prej vitesh me këtë sëmundje (si unë) dhe shumë prej ilaçeve i kam bërë. Pse të mos vijnë edhe në Shqipëri ilaçet e fundit, që të ketë sa më shumë alternativa. Pastaj kimioterapia ...Pak shtretër e shumë pacientë. Të rrish në radhë me orë të tëra për të bërë kimioterapinë. Për mua ky është një problem serioz.

Ka shumë vajza dhe gra që janë si ti optimiste dhe e duan jetën kaq shumë. Por çfarë mund t'u themi atyre që kanë humbur forcën dhe optimizmin?

Kam vendosur të flas e të tregoj për sëmundjen time, për t'u dhënë forcë e kurajo të gjithë atyre njerëzve që u ra fati të përballen me sëmundje të tilla. Jeta ka ngjyra të shumta. Ndodh që në një

jete. Me forcë e kurajë mund t'ia dalim mbanë. Mos e ndalni luftën tuaj asnjë moment! Në fund të fundit jeta është një luftë për mbijetesë.

Mendon se aktivitetet ndërgjegjësuese e rrisin vetëdijen e vajzave dhe grave për t'u kujdesur më shumë për shëndetin e tyre?

Patjetër që po. Sa më shumë informacion, sa më shumë ndërgjegjësim, sa më shumë kontrollë. Kjo sëmundje, mund të kurohet nëse kapet në kohë.

Një ditë ndryshe, një ditë shkëputur nga realiteti. Si është kjo në mendjen tënde, ku dhe si?

Jeta ime tashmë është një jetë normale, sepse kam mësuar të bashkëjetoj me sëmundjen time. Unë e shijoj jetën ashtu siç vjen me ditët plot diell apo me stuhitë e fuqishme. Jo pa qëllim lulja ime është lulëdielli. Pavarësisht stuhive, rrebesheve, ajo e kthen kokën nga dielli, sepse aty e gjen jetën. Edhe unë dua diellin në jetën time...të tjerat s'kanë rëndësi.



Dr. Orges Spahiu
Shef i Njësise së Radioterapisë,
Shërbimi Onkologjik - QSUT

Fakte thelbësore mbi kancerin

Kanceri është shkaku i dytë kryesor i vdekshmërisë globale dhe përgjegjës për 9.6 milion vdekje në vitin 2018. Sot në botë rreth 1 në 6 vdekje ndodh si pasojë e kancerit. Afërsisht 70% e vdekjeve nga kanceri ndodhin në vendet me të ardhura të ulëta e të mesme.

Rreth 1/3 e vdekjeve nga kanceri janë si pasojë e 5 rreziqeve kryesore lidhur me stilin e jetesës dhe dietën: indeksi i mbipeshës trupore, sasia e paktë e frutave dhe perimeve, mungesa e aktivitetit fizik, përdorimi i duhanit dhe përdorimi i alkoolit.

Përdorimi i duhanit është një faktor më i rëndësishëm i rrezikut për kancerin, përgjegjës për rreth 22% të vdekjeve nga kanceri. Infeksionet shkaktare të kancerit si hepatiti dhe Human papilloma virus (HPV) janë përgjegjëse përderisa në 25% të rasteve me kancer në vendet me të ardhura të ulëta e të mesme.

Paraqitja në stadet e avancuara dhe mungesa e aksesit në diagnostikim dhe trajtim janë të zakonshme. Në vitin 2017, vetëm 26% e vendeve me të ardhura të ulëta raportuan se kanë shërbime të disponueshme për këtë patologji kryesisht në sektorin publik. Më tepër se 90% e vendeve me të ardhura të larta kane të disponueshme shërbimet e trajtimit krahasuar me më pak se 30% e vendeve me të ardhura të ulëta.

Impakti ekonomik i kancerit është domethënës dhe është në rritje. Kostoja ekonomike vjetore e kancerit në vitin 2010 ishte rreth 1.16 trilion US \$. Vetëm 1 në 5 vende me të ardhura të ulëta e të mesme ka të dhënat e nevojshme për të nxitur politikat për kancerin.

Kanceri është një term i përgjithshëm për një grup të gjerë sëmundjesh që prekin çdo pjesë të trupit. Term atë tjerë të përdorur janë tumoret malinje dhe neoplazitë. Një tipar përcaktues i kancerit është krijimi i shpejtë i qelizave anormale që rriten përtej kufijve të tyre normal. Këto më tej mund të pushtojnë pjesët fqinje të trupit duke u përhapur në organe të tjera, proces ky i cili i referohet metastazimit të sëmundjes. Metastazat e sëmundjes janë shkaktari më i madh i vdekjeve nga kanceri.

Problemi

Kanceri është një nga shkaqet kryesore të vdekjes në mbarë botën, përgjegjës për rreth 9.6 milion vdekje në vitin 2018. Tumoret më të shpeshta vijnë sipas radhës:

- Mushkëritë (2.09 milion raste)
- Gjiri (2.09 milion raste)
- Kolo-rektum (1.80 milion raste)
- Prostata (1.28 milion raste)
- Kanceri i lëkurës (jo melanotik)
- (1.04 milion raste)
- Stomaku (1.03 milion raste)

Shkaqet më të zakonshme të vdekjes nga kanceri janë:

- Mushkëritë (1.76 milion vdekje)
- Kolo-rektum (862 000 vdekje)
- Stomaku (783 000 vdekje)
- Mëlçia (782 000 vdekje)
- Gjiri (627 000 vdekje)

Çfarë e shkakton kancerin?

Kanceri krijohet nga transformimi i qelizës normale në qeliza tumorale në një proces që kalon në stade të ndryshme. Sëmundja zakonisht progreson nga

Plakja e popullsisë është një faktor themelor i zhvillimit të kancerit. Incidenca e kancerit rritet dramatisht me moshën, veçanërisht për disa lloje tumoresh. Akumulimi i rreziqeve të përgjithshme kombinohet me tendencën e mekanizmave të riparimit qelizor për të qenë më pak efektiv ndërkohë që një person plakët.

Faktorët e rrezikut për kancerin

Përdorimi i duhanit, alkoolit, dieta e pashëndetshme dhe aktiviteti i mangët fizik janë faktorë kryesorë të rreziku të kancerit në mbarë



një lezion pre-kanceroz në një tumor malinj. Këto ndryshime janë si rezultat i ndërveprimit mes faktorëve gjenetikë të një personi dhe 3 agjentëve të jashtëm që përfshijnë:

- Karcinogjenet fizike, siç janë rrezatimi ultraviolet dhe ai jonizues;
- Karcinogjenet kimike, siç janë asbesti, përbërësit e tymit të duhanit, alfatoksina (një kontaminues i ushqimit), dhe arseniku (një kontaminues i ujit të pijshëm); dhe
- Karcinogjenë biologjikë, siç janë infeksionet nga disa lloj virusesh, baktere ose parazitësh.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) nëpërmjet Agjensisë së saj të kërkimit për kancerin (IARC) mban një klasifikim të agjentëve shkaktarë të kancerit.

botën. Këta 4 faktorë rreziku vlejnë edhe për sëmundjet të pa transmetueshme (NCDs).

Disa infeksione kronike janë faktorë rreziku për kancerin dhe kanë rëndësi të madhe në vendet me të ardhura të ulëta e të mesme. Afërsisht 15% e tumoreve të diagnostikuar në vitin 2012 i atribuoheshin infeksioneve karcinogjenike, duke përfshirë Helikobakter pilori, Human papilloma virus (HPV), Hepatiti viral B, Hepatiti C dhe virusi Epstein –Barr (EBV).

Hepatiti B dhe C e disa tipe të HPV-së rrisin rrezikun për kancerin e mëlçisë dhe të qafës së mitrës. Infeksionet me HIV rrisin në mënyrë domethënëse rrezikun e kancerit të qafës së mitrës.

Reduktimi i barrës së kancerit

Përreth 30-50% e sëmundjeve të kancerit aktualisht mund të parandalohen duke shmangur faktorët e rrezikut dhe duke zbatuar strategjitë parandaluese të bazuara në evidenca. Barra e kancerit mund të reduktohet gjithashtu nëpërmjet zbulimit të hershëm të kancerit dhe menaxhimit të pacientëve që sëmuren me kancer. Mjaft lloje kanceri kanë një shans të lartë të kurimit nëse diagnostikohen herët dhe trajtohen në mënyrë adekuate.

Modifikimi dhe shmangia e faktorëve të rrezikut

Të modifikosh ose të shmangësh faktorët kyç të rrezikut mund të reduktojë në mënyrë domethënëse peshën e kancerit. Këto faktorë rreziku përfshijnë:

- Përdorimi i duhanit, përfshirë cigaret dhe duhanin pa tym
- Mbipesha ose obeziteti
- Dieta e pasqendësuar me sasi të pakta frutash dhe perimesh
- Mungesa e aktivitetit fizik
- Përdorimi i alkoolit
- Infeksionet-HPV seksualisht të transmetueshme
- Infeksionet nga hepatiti ose infeksione karcinogjenike të tjera
- Rrezatimi jonizues dhe ultraviolet
- Ndotja e ajrit në zonat urbane
- tymi i brendshëm nga përdorimi shtëpiak i lëndëve djegëse të ngurta

Përdorimi i duhanit është faktori më i veçantë i rrezikut për kancerin dhe është përgjegjës për afërsisht 22% të vdekjeve në lidhje me kancerin në të gjithë globin.

Ndjekja e strategjive të parandalimit

Për të parandaluar kancerin, njerëzit duhet:

- Të rrisin shmangien e faktorëve të rrezikut të listuara më lart;
- Të vaksinohen kundër virusit HPV_së dhe hepatitit B
- Të kontrollojnë rreziqet profesionale
- Të reduktojnë ekspozimin ndaj rrezatimit ultraviolet
- Të reduktojnë ekspozimin ndaj rrezatimit jonizues (profesional ose atë diagnostik mjekësor)

Vaksinimi ndaj virusit HPV dhe hepatitit B mund të parandalojë 1 milion raste me kancer çdo vit.

Zbulimi i hershëm

Vdekshmëria nga kanceri mund të reduktohet nëse rastet zbulohen dhe trajtohen herët. Ka dy komponentë të zbulimit të hershëm:

Diagnoza e hershme

Kur identifikohet herët kanceri ka më shumë gjasa t'i përgjigjet trajtimit efektiv dhe të rezultojnë probabilitet më të madh mbijetese, sëmundshmëri më të ulët dhe trajtim me kosto më të reduktuar. Zbulimi i hershëm dhe shmangia e vonës në trajtimin e kancerit mund të përmirësojnë ndjeshëm jetën e pacientëve.

Diagnoza e hershme konsiston në 3 hapa që duhet të integrohen dhe sigurohen në kohë:

- Ndërgjegjësim dhe aksesim i kujdesit shëndetësor
- Vlerësim klinik, diagnoza dhe stadifikimi
- Aksesimi në trajtim

Diagnoza e hershme është e rëndësishme në të gjitha rrethanat dhe në pjesën më të madhe të sëmundjeve të kancerit. Në mungesë të diagnozës së hershme, pacientët diagnostikohen në stadi të vona, atëherë kur trajtimi nuk mund të jetë më një opsion. Duhet dizenuar programe për të reduktuar vonesat dhe barrierat e kujdesit shëndetësor duke e lejuar pacientin të aksesojë trajtimin në kohën e duhur.

Depistimi

Qëllimi i depistimit është të identifikojë individë me anomalitë që i takon një kanceri specifik apo një fazë pre-kanceroze që nuk ka treguar ndonjë shenjë apo simptomë dhe t'i referojnë ato për diagnostikim dhe më pas trajtimin.

Programet e depistimit mund të jenë efektive për disa lloje kanceri, kur përdoren testet e duhura, dhe kur zbatohen efektivisht, të lidhura me hapat e tjerë të procesit të depistimit dhe kur sigurohet cilësia.

Në përgjithësi, një program depistimi është një

ndërrhyrje shumë më komplekse e shëndetit publik se diagnostikimi i hershëm.

Shembuj të metodave të depistimit janë:

- Inspektimi vizual me acid acetic (VIA) për kancerin e qafës së mitrës në vendet me të ardhura të ulëta
- Testi HPV_se për qafën e mitrës
- PAPtesti për kancerin e qafës së mitrës në vendet me të ardhura të mesme e larta
- Dhe ekzaminimi me Mamografi për kancerin e gjirit në vende me sisteme shëndetësore të konsoliduara.

Trajtimi

Një diagnozë e saktë është esenciale për një trajtim efektiv dhe adekuat pasi çdo lloj

kanceri kërkon një regjim trajtimi specifik që përfshin një ose më shumë modalitete të tilla si kirurgjia, radioterapia dhe kimioterapia. Përcaktimi i qëllimeve të trajtimit dhe kujdesit paliativ është një hap i parë i rëndësishëm dhe shërbimet shëndetësore duhet të integrohen dhe të përqendrohen tek njerëzit. Qëllimi parësor është përgjithësisht të kurojë kancerin ose të zgjasë në mënyrë të konsiderueshme jetën. Përmirësimi i cilësisë së jetës është gjithashtu një qëllim i rëndësishëm. Kjo mund të arrihet nëpërmjet kujdesit paliativ dhe suportit psikologjik.

Shanset e kurimit të kancerit të diagnostikuar herët

Disa lloje kanceri, edhe kur qelizat kanceroze kanë udhëtuar në pjesë të tjera të trupit, si seminoma testikulare, leucemia dhe limfomat tek fëmijët, mund të kenë kurabilitet të lartë kur ofrohet dhe sigurohet trajtim i duhur.



Rriti flokët për t'i dhuruar, historia frymëzuese e Donjetit



Fushata e dhurimit të flokëve tek Europa Donna Albania ka ndikuar shumë njerëz të dhurojnë flokët e tyre për një kauze kaq të ndjeshme sa është kanceri i gjirit. Historitë e dhuruesve të flokëve janë nga më të ndryshmet por ne do të ndajmë sot me ju një histori frymëzuese.

Dhurimi i flokëve nga gjinia mashkullore për gratë me kancer gjiri, është gjest i veçantë. I tillë është Donjeti, 28-vjeçari nga Kosova, i cili është i pari djalë që ka dhuruar flokët për këtë kauzë në Shqipëri. Nga nëntori i 2016-ës deri në nëntor të 2018-ës, Donjeti nuk vuri gërshërë e as makinë mbi flokët e tij.

Pas dy vitesh, Donjeti vendosi të presë flokët dhe pas një kërkimi në Internet, u njoh me nisëm e 'Europa Donna Albania' dhe vendosi t'i dhurojë flokët për këtë kauzë.

Por si nisi e gjitha? Pse Donjeti vendosi të dhuronte flokët?

Historia ime fillon kështu: Krejt rastësisht kam takuar një grua që po kërkonte të blinte paruke mirëpo fatkeqësisht ajo nuk kishte mundësi ta përballonte një paruke me flokë natyrale.

Dëshira e saj ishte ta kishte një paruke të tillë. Dhe nga këtu filloi gjithçka. Unë në fakt i rrita flokët për të sepse atë ditë i premtova që do t'ja siguroja një paruke me flokë natyrale.

Por ajo fatkeqësisht nuk arriti ta përballojë sëmundjen. Më vonë hulumtova për organizata që unë mund të dhuroja flokët për këtë kauzë dhe kështu gjeta Donjeta Zeqan dhe i dërgova tek ajo me postë për tek Europa Donna Albania.

Donjeti vazhdon më tej rrëfimin e tij i cili tregon se

iniciativa të tilla i ka ndjekur por asnjëherë nuk ka qenë i përfshirë kaq afër sa kjo kauzë e cila e bëri të rriste flokët dy vite. Ai tregon se është thujse i informuar mjaftueshëm për kancerin e gjirit dhe se meshkujt kanë një rol kyç në mbështetjen që i duhet bërë vajzave dhe grave në një situatë të tillë sidomos.

Donjeti e përmbyll rrëfimin e tij për 'Europa Donna Albania' me një mesazh:

"Kjo sëmundje nuk është më sëmundja më e keqe në botë. Me zhvillimin e mjekësisë dhe farmaceutikes kjo sëmundje dalëngadalë po mposhtet dhe pika më e fortë për të luftuar këtë sëmundje është energjia pozitive dhe dëshira për të fituar këtë betejë. Këtë sëmundje mund ta mposhtim së bashku. MOS U DORËZO ASNJËHERË!"



Sondazhi në Evropën Qendrore dhe Lindore, të dhënat për pacientët me kancer

Në datën 4 shkurt të vitit 2019, në 12 vende filloi zbatimi, promovimi dhe shpërndarja e studimit të parë rajonal në formën e një pyetësori/ankete për pacientët me tumore solide dhe ato të gjakut.

Këto të dhëna të mbledhura nga 4 shkurti deri në 19 maj, kishin si qëllim ekspozimin e nevojave reale të pacientëve në segmente të ndryshme të kujdesit të kancerit dhe janë analizuar për të gjitha vendet e përfshira. Përpunimi është bërë nga Koalicioni i Shoqatave të Shëndetësisë në Zagreb (KUZ - Coalition of Association in Healthcare, Croatia), që ishte dhe përgjegjëse për takimin e organizatave të pacientëve në rajon.

Sondazhi mbi rezultatet e rëndësishme për pacientët me kancer në Rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore është e para nismë rajonale (dhe e para e këtij lloji).

Europa Donna Albania u mor specifikisht në Shqipëri për promovimin dhe shpërndarjen e sondazhit. Në komunikimet e vazhdueshme përmes takimeve me pacientët, ëbsite-t dhe rrjeteve sociale, EDA i dha zë dhe jhonë rëndësisë së mbledhjes së të dhënave për çdo pacient me kancer.

Rezultatet e sondazhit janë një e dhënë e shkëlqyer dhe shumë e rëndësishme për çdo shtet të përfshirë. Këto të dhëna mund t'i përdorim kudo (në shtetet) tona për të pasur një ide më të qartë se “çfarë po ndodh” dhe për një impakt më të

madh tek institucionet përgjegjëse në marrjen e vendimeve për këtë kategori pacientësh.

Sondazhi mbi rezultatet e rëndësishme për pacientët me kancer në Rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore, është një ide e hartuar para dy vitesh, në takimin e parë të organizatave të pacientëve të këtij rajoni, që u zhvillua në Opatija të Kroacisë dhe pasoi më dy takime të tjera ku dhe më 18-19 qershor të këtij viti u publikuan të dhënat e përpunuara për çdo shtet.

Që prej takimit të parë Europa Donna Albania ka përfaqësuar Shqipërinë duke dhënë kontribut në hartimin e planit dhe strategjisë si dhe në promovimin e sondazhit. Të dhënat janë përkthyer në shqip nga Europa Donna Albania


864 pacientë me kancer iu përgjigjën sondazhit - një numër i konsiderueshëm.

55.67% e të anketuarve ishin me kancer të gjirit dhe **81.37%** e të anketuarve ishin femra (që do të thotë se është e nevojshme t'i kushtohet shumë vëmendje kësaj kategorie).


Shumica e të anketuarve kanë shkuar tek mjeku pasi kanë ndjeur diçka në trupin e tyre - kjo do të thotë: ne duhet të përqendrohemi më shumë në edukim. Duhet të bëjmë më shumë rreth informimit për popullsinë e Shqipërisë për këtë problem serioz.

Personal information - type of cancer

Lloji i kancerit




Gjinia



■ Meshkuj
■ Femra

Gjinia e personave të përfshirë në pyetësor (paciente) (N = 864)

Si u diagnostikuar me kancer?



■ Në kuadrin e një programi kontrolli rutinë
■ Në kuadrin e një programi kontrolli për një problem shëndetësor tjetër
■ Shkova te mjeku sepse ndjeja që diçka nuk shkonte mirë me shëndetin tim

Si u diagnostikuar me kancer? (N = 864)

3rd JACPO June 18th - June 19th 2019

* Të dhënat e plota mund t'i gjeni në faqen tone në website: www.europadonna.al.
Jeni të ndaluar të merrni të dhënat e sondazhit pa cituar burimin dhe Europa Donna Albania

Kanceri i gjirit, një kauzë që meriton vëmendjen e të gjithëve ne

Tetori është një muaj ndryshe në gjithë globin, pasi njihet ndërkombëtarisht si “Tetori Rozë”, indicie dhe kampanë alarmi për çdo vajzë e grua. Ky tetor është ndryshe, dehe bizneset dhe kompanitë, pasi kanë kthyer një sy drejt kësaj kauze. Një prej tyre është Coin, i cili që me datën 4 tetor ka nisur fushatën “Think Pink” (Mendo rozë) në mbështetje të kësaj kauze.

Fjongoja, sfondi, veshjet dhe një palmë rozë janë vitrina kryesore e këtij tetori sa kalon tek “Coin”. Një ambient i përbërë nga një staf ku mbizotërojnë vajza dhe gra, nuk mund të rrinte indiferent ndaj kësaj kauze. Teksa në ditë të tjera, ato janë këshillueset e sugjerueset më të mira për të ndarë idetë me trendet dhe tendencat, këto ditë kur të gjithë sensibilizojnë dhe ndërgjegjësojnë, natyrshëm u vjen të ndajnë përfaqime me vajzat dhe gratë që po sfidohen nga kanceri i gjirit.

Por si mund të kontribuoni edhe ju ndaj kësaj kauze dhe fushatës së Tetorit Rozë?

Në çdo kasë të Coin ndodhet një kuti transparente, me mbishkrimin: “Le të bëjmë një kontribut të gjithë sëbashku!”.



Kontributi final i Coin do të jetë duke dyfishuar shumën totale të dhuruar nga klientët dhe duke i ardhur në ndihmë EUROPA DONNA ALBANIA në eventin “Dhuro flokë, fal shpresë” dhe kauzës që kjo organizatë ka për gratë me kancer gjiri.

“Ju jeni të forta, ju jeni të bukura dhe asnjë sfidë nuk mund t’ju ndalojë, këtë na e keni vërtetuar vetë ju!”- është mesazhi që Coin ka për të gjitha vajzat dhe gratë me kancer gjiri.



Partnerët e “Tetorit Rozë” të Europa Donna Albania

- Roche
- Novartis
- Big Market
- Pfizer
- Coin Albania
- Iceberg Communication
- Porsche Albania
- GLOBAL (part of IRISGROUP)
- MY SPA
- Mon Cheri
- Smart Social
- Erboristeria di Klea
- Memory Craft





E-mail: europadonnaalbania@hotmail.com

E-mail: info@europadonna.al

Facebook: Europa Donna Albania

Instagram: [europadonnaalbania](https://www.instagram.com/europadonnaalbania)

Twitter: Europa Donna Albania (@donnaalbania)

Linkedin: Europa Donna Albania



U mbështet nga:



NOVARTIS

